



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 78, datë 15.07.2010

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 08.02.2007, “PËR LISTËN E DOKUMENTAVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE DHE PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenin 14, pika 6, m) dhe pika 10, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në Udhëzimin nr. 10, datë 08.02.2007, “Për listën e dokumentave të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit” në listën e dokumentave që përbëjnë llogaridhënien e detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit, pas pikës 27 shtohet pika 28, 29, 30 me përmbajtje si më poshtë:

28. llojet e investimeve të tjera financiare të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, duke specifikuar depozitat për fondin e garancisë, depozitat në institucione të tjera krediti dhe investimet në bono thesari;

29. depozitat e bllokuara të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit lënë si Cash kolateral, Garanci për palët e treta dhe forma të tjera gjatë periudhës së raportimit;

30. klasifikimin e debitorëve të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit sipas moshës së tyre, në periudhat përkatëse”.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI